



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Ambasada e Zvicrës në Shqipëri

RAPORT

ANALIZA E PYETESOREVE NE BASHKINE MALLAKASTER

PROJEKTI: 'TE RINJTE VEPROJNE-KOMISIONI KESHILLIMOR MALLAKASTER'

IMPLEMENTUAR NGA EPOKA E RE, FIER, FINANCUAR NGA LEVIZALBANIA

**PROBLEMATIKAT RINORE EDHE INFORMACIONI PËR
AKTIVITETET E QEVERISJES LOKALE**

PUNOI: Erjo MILE

Përmbajtja

Hyrje.....	4
Metodologjia.....	5
Të dhënat e përgjithëshme të kampionit	7
Informacioni për Qeverisjen Vendore.....	11
Problematikat Rinore dhe informacioni mbi aktivitetet social-kulturore	17
Rekomandime	30

Tabela e Grafikëve

Grafik 1- Gjinia	7
Grafik 2- Grupmosha.....	7
Grafik 3- Arsimi	8
Grafik 4- Profili- Arsimi dhe Punesimi	9
Grafik 5- Të Ardhurat	10
Grafik 6- Organi Vendimmarrës	11
Grafik 7- Informacioni mbi O.Vendimmarrës-Arsimi	12
Grafik 8- Mbledhjet e Këshillit Bashkiak	13
Grafik 9- Mbledhjet e K. Bashkiak- Arsimi	14
Grafik 10- Pjesëmarrja në mbledhjet e Këshillit Bashkiak	15
Grafik 11- Informacioni mbi Këshilltarët.....	16
Grafik 12- Funkcionet e Kryetarit të Bashkisë.....	16
Grafik 13- Ndikimi I Qeverisjes locale ne politikat Rinore	18
Grafik 14- Problematikat Rinore	19
Grafik 15- Pushteti Vendor- problemet Rinore.....	20
Grafik 16- Aktivizmi I te rinjve.....	21
Grafik 17- Stakeholders- grupet e interesit	22
Grafik 18- Pjesëmarrja ne aktivitete lokale.....	23
Grafik 19- Organizimi I aktiviteteteve per te rinjte.....	24
Grafik 20- Informacion mbi Strategjine e Rinise	25
Grafik 21- Aktivizmi I te rinjve- Qeverisje	26
Grafik 22- Qeverisja locale- komuniteti	27
Grafik 23- Roli I institucioneve ne aktivizmin e te rinjve	28

Grafik 24- Informacion mbi Grupet Keshillimore te te Rinjve	29
Grafik 25- Rendesia e Grupeve Keshillimore aktive.....	29

Hyrje

Ky studim ka në fokus të rinjtë e Bashkisë Mallakastër, dhe synon të njoh më shumë informacionin dhe dijet që të rinjtë kanë për pushtetin lokal. Si dhe të sjell një pamje më të qartë të lidhjes dhe ndërveprimit të pushteti lokal, me të rinjtë e kësaj zone.

Studimi është bërë nga Qendra Rinore “Epoka e Re” Fier në kuadër të projektit Komisioni Këshëllimor Rinor Mallakastër “Të rinjtë veprojnë” financuar nga Programi Lëviz Albania. Synimi i studimit është që të sjell informacion të saktë e të drejtpërdrejtë, të krijoj një tablo sa më të qartë të situatës, me qëllim që Projekti të shtrihet mbi një teren të qëndrueshem informacioni edhe të lehtësoj implementimin e tij, duke u bërë sa më produktiv e duke dhënë rezultate të prekshme.

Në bazë të këtij studimi, implementuesit e Projektit do të njohin të gjitha difektet dhe dobësitë e kësaj lidhje dyfishe “Rini – Pushtet Lokal” në Bashkinë e Mallakastres. Por ne shpresojmë që rezultatet e këtij studimi të kenë një dobishmëri më të gjerë. Tabloja e ralitetit që ky studim sjell, pikat e dobëta dhe problematikat që ai reflekton, shpresojmë ti hyn në punë edhe institucioneve të pushtetit lokal, institucioneve e organeve të tjera qeveritare, organizatave të tjera jofitimprurse që veprojnë në këtë bashki, dhe mbi të gjitha vetë komunitetit që jeton në këtë Bashki.

Studimi shtrihet mbi të gjithë Bashkinë Mallakaster, duke ju referuar ndarjes së re administrative të ndodhur në vitin 2015. Ai shtrihet në të nënta Njësitë Administrative të Mallakasterit duke respektuar peshën specifike që mbartë secila nga ato mbi popullsinë. Studimi ndahet në katër grupmosha duke respektuar me korrektësi secilen prej tyre në përfaqësim. Gjithashtu ky studim respekton barazinë gjinore, duke i dhënë secilës gjini një peshë të barabartë, 50% vajza edhe 50% djem.

Metodologjia

Ky studim ka si qëllim të masë edhe të njoh njohurit edhe bashkëpunimin e të rinjëve me Pushtetin Lokal. Popullsia e këtij studimi janë të rinjtë e moshës 16-28 vjeç, që banojnë në Bashkinë e Mallakasterit. Kemi përcaktuar këtë grupmoshë sit ë rinjë për arsyen se mosha 16 vjeç është mosha kur personi arrin pjekurinë e plotë seksuale dhe psikologjike. Dhe mosha 28 vjeçare është përcaktuar si kufij për shkakun se është mosha kur individi ka arritur pjekurinë e plotë fizike, arsimore, dhe sociale.

Metoda e përdorur është ajo sasiore, ku si mjet të mbledhjes së të dhënave ky studim ka një pyetësor me 24 pyetje. Pyetjet për të dhënat personale janë gjashtë, ku përfshihet gjinia, mosha, arsimimi, statusi social, vendbanimi fshat-qytet, si dhe të ardhurat familjare. Pyetja për të ardhurat është bërë me qëllimin për të patur një ide më të qartë të gjendjes ekonomike të popullatës që ne kemi në fokus, por edhe të kampionit tonë. Ne kemi përdorur metodën britanike dhe i kemi vendosur në fillim pyetjet personale. Për shkakun se pyetjet e mëpasme nuk ndikohen nga karakteristikat personale të kampionit. Pyetësori është i ndarë në tre seksioni, në të cilin përveç seksionit të parë që janë pyetjet personale, në seksionin e dytë janë pyetjet për qeverisjen vendore, dhe në seksionin e tretë janë pyetjet për problematikat rinore dhe informacioni për aktivitetet e Qeverisjesë Lokale. Të dyja seksionet e pyetjeve janë ndërtuar respektivisht me qëllimin e pyetësorit. Në seksionin e dytë qëllimi është të maten njohurit e të rinjëve mbi pushtetin vendor. Edhe në seksionin e tretë qëllimi është të vilet informacion mbi gjëndjen e situatës, problematikat rinore të të rinjëve në këtë bashki, dhe aktivitetet që realizon pushteti lokal për të rinjtë. Pra në seksionin e tretë matet drejtpërdrejt lidhja mes të rinjëve edhe Pushtetit Lokal.

Pyetjet në pyetësor janë të mbyllura. Tre pyetje në alternativat e tyre japin mundësinë e një pyetje të hapur. Konkretisht pika f) e pyetjes 11, pika n) e pyetjes 13, dhe pika e) e pyetjes 19 të japin mundësinë e një pyetje të hapur. Tetë pyetje janë pyetje të mbyllura me –PO –JO dhe – Pa Përgjigje. Ndërsa dhjetë pyetje janë më alternative. Disa pyetje janë ndërtuar në formë kuici, funksioni i tyre është latent. Në këto pyetje ka alternative të sakta edhe të gabuara, dhe në bazë të përgjigjeve të mbledhura bëhet një vlersim i kampionit se sa i saktë është informacioni që ai


posedon. Por shumica e pyetjeve janë të drejt për drejta, të cialt marrin informacion rreth situatës konkrete ose masin opinionin e popullatës.

Kampionimi që ne kemi përdorur është miksi, kampionim i rastësishëm me kuota – i shtresëzuar. Me qëllim që të ishim sa më përfaqësues në të gjithë Bashkinë e Mallakasterit, me të dya gjinitë, dhe me të gjitha grupmoshat ne zgjedhëm këtë lloj kampionimi. Në kampionin tonë gjinitë përfaqësohen 50% me 50%. Në e ndam kampionimin tonë në katër grupmosha, 16-18 që përfshin gjimnazistët edhe adoleshencën e hershme, 19-21 që përfshin studentët edhe adoleshentët e vonë, 22-24 të rinjtë e maturuar edhe 25-28 që janë të rinjtë më të ritur edhe të pjekur, në moshën kur mundet ti ken përfunduar plotësishtë studimet e të jenë të punsuar. Secilës grupmosh i dhamë një përfaqësueshmëri prej 25%, me qëllimin që të përfaqësohen në mënyrë sa më të barabartë. Për të respektuar përfaqësueshmërinë ne i dhamë secilës Njësi Administrative të Bashkisë Ballësh një kuotazh të caktuar, i cili ishte në përputhje të plotë me numrin e popullsisë të secilës Njësi Administrative. Bashkia e Mallakasterit ka nëntë Njësi Administrative të cilat në kampionim zënë një peshë specifike të barabartë me numrin e popullsis që kanë.

Metoda e Kampionimit është “Verigia e rrushit” , e cila respekton rastësishmërinë. Kampionimi filloj nga gjimnazi i Mallakasterit, kun ë mënyrë të rastësishme i zgjedhën nëntë të rinjë, një për secilën Njësi Administrative, dhe nga të cilët filloj kampionimi. Numri i pyetësorëve është 100, një kuotë e mjaftueshme për të vjelë informacionin e kërkuar duke marrë në konsideratë edhe numrin jo shumë të lartë të banorëve të Bashkisë Ballësh që është afërsisht 44800 banorë.


Të dhënat e përgjithëshme të kampionit

Kampioni është i përbërë nga 50% vajza edhe 50% djemë, në një ndarje të barabartë siç ishte edhe qëllim i këtij studimi.



Grafik 1- Gjinia


Nëse do ti ndanim për nga grupmosha, social grup-moshë është e përfaqësuar me një peshë specifike 25%. Por secila grup-moshë në bazë të gjinisë është e ndarë: grup-mosha 16-18 13% vajza dhe 12% djem, grup-mosha 19-21 11% vajza dhe 14% djem, grup-mosha 22-24 12% vajza dhe 13% djem, grup-mosha 25-28 14% vajza edhe 11% djem. Kjo vjen si rezultat i kampionimit “Verige rrushi” i cili duke u ndjekur me kujdes edhe nga realizuesit e studimit ka dhënë rezultatin e dëshiruar të një studimi përfaqëzues me kuotë të ndrajes së barabartë 50 me 50.



Grafik 2- Grupmosha

Në bazë të variablilit të vendbanimit, fshat – qytet, pasha specifike e të rinjëve që banojnë në zonat rurale është më e lartë 64%, ndërsa në qytet 36%. Kjo është diçka e pritëshme për shkakun se Mallakasteri tetë Njësi Administrative i ka në zonë rurale. Madje pritej të ishte më e lartë pesha specifike e të pyeturve nga zonat rurale, por ndarja e re administrative-teritoriale, dhe migrimi i brendshëm si dy faktor të rëndësishëm, reflektohen edhe në të dhënat që ka grumbulluar kampionimi jonë.

Për nga arsimimi kampioni i pyetur nga në këtë studim përbëhet nga 20% me arsim 9-vjeçar, 50% me arsim të mesëm edhe 30% me arsim të lartë. Të ndara në bazë të gjinive, arsimi i kampionit reflekton si në tabelën e mëposhtme, që tregojnë se 24% e vajzave janë me arsim 9-vjeçar, 46 me arsim të mesëm dhe 30% me arsim të lartë. Ndërsa te djemt 16% janë me arsim 9-vjeçar, 54% me arsim të mesëm dhe 30% me arsim të lartë.




Grafik 3- Arsimi

Të dhënat tregojnë një numër më të madh vajzash me arsim 9-vjeçar edhe një numër më të lartë djemsh me arsim të mesëm. Ky është një pasqyrim i një fenomeni tradicional të shoqërisë shqipëtare, ku një pjesë e vajzave e ndërprisnin arsimimin e mesëm për shkak të mentalitetit të familjeve të tyre. Kjo dukuri vërtetohet edhe kur shikojmë të dhënat për grup-moshën 22-24 dhe

grup-moshën 25-28. 50% e vajzave të pyetura në grup-moshën 22-24 janë me arsim 9-vjeçar, ndërsa në grup-moshën 25-28 ishin 35.7% . Djemtë i kishin shumë herë më të ulta këto të dhëna.

Për nga statusi social të dhënat marrin më shumë kuptim nëse ato i korelojmë me arsimimin. Kjo na tregon një pamje më të qartë se çfarë profilesh bëjnë pjesë në kampionimin tonë. Të dhënat në tabelën e mëposhtme na krijojnë një pamje më konkrete të profilit të kampionit tonë.




Grafik 4- Profili- Arsimi dhe Punesimi

Tabela na tregon gjëndjen e kampionimit që është një pasqyrim edhe i gjëndjes së përgjithëshme të të Rinjëve në Mallakaster. Me jeshile në tabelë tregohet papunësia, e cila është e lartë kudo në të treja kategoritë e arsimimit. Në studimin tonë 24% janë nxënës në total. Kjo shifër ndikohet më së shumti nga grup-mosha 16-18 të cilët më së shumti janë në procesin e arsimimit të nivelit 9-vjeçar ose të mesëm. 11% janë student krahasuar me 30% që kanë thënë që i përkasin arsimit të lartë. Rrjedhimisht 19% e kanë përfunduar ciklin e arsimit të lartë. Shifrat e papunisë janë tepër të larta, aq sa mundet të cilësohen si të frikshme. Papunësia tek të rinjtë në Mallakaster është 47%, gati gjysma e tyre janë të papunë. Duhet të kemi parasysh që 35% janë ende në procesin e arsimimit. Papunësia është e lartë edhe tek të rinjtë me arsim të lartë, 16%, gjë e cila tregon një situatë shumë të keqe të punësimit rinor në Mallakaster. Kjo tregohet edhe tek ata që

punojnë me kohë të pjesëshme që është vetëm 14%. Por akoma më problematike është punsimi me kohë të plotë në këtë zonë që është vetëm 5%.

Të dhënat e mësipërme të statusit dhe arsimimit të koreluara, nxjerin në pah një problematik rinore të kudogjëndur në Shqipëri, papunsinë. Por shifrat në këtë bashki janë shumë të larta, ku të punuar me kohë të plotë ose jo të plotë janë 19%. Shumë i lartë është edhe treguesi i papunësisë tek të arsimuarit e nivelit të lartë. Ky mundet të jetë një tregues që tregu i punës në Mallakaster nuk kërkon një kualifikim të lartë.

Për të njohur edhe nivelin ekonomik të kampionit tonë, në i drejtuam atij një pyetje për të ardhurat familjare. Ky informacion na shërben vetëm për të kjuar një ide se me çfarë shtresash të shoqërisë kemi të bëjmë më së shumti, edhe për të marrë sadopak një pasqyrim të gjendjes ekonomike të rinisë në Ballësh. Dhe kjo tablo paraqitet në tabelën e mëposhtme.




Grafik 5- Të Ardhurat

Vetëm 14% e të rinjëve pohojnë se kanë të ardhura familjare më shumë se 50 000 lekë , dhe asnjë nuk deklaroi se ka më shumë se 100 000 lekë. 19% e të rinjëve japin përgjigjen se të ardhurat e tyre familjare janë më pakë se 25 000 lekë. Është 0% pasha specifike e të ardhurave familjare më shumë se 100 000 lekë. Dominon me 38% përgjigja e të rinjëve që kanë të ardhura familjare 25 000 – 50 000 lekë, që përfaqësojnë shtresën e mesme edhe të mesme të ulët në

shoqëri. Në pjesën më të madhe kampioni jonë është nga shtresa e ulët edhe e mesme e ulët e shoqërisë. Ky është një pasqyrim i realitetit ekonomik të zonës së Mallakasterit. Por e lartë është edhe pasha specifike e të rinjëve që zgjedhin alternativën “Nuk e di” për përgjigje, 14%. Ky është një tregues se shumë të rinjë, sidomos adoleshentët dhe adoleshentët e hershëm, janë të shkëputur nga problematikat familjare dhe pak të interesuar për gjëndjen financiare, por jo vetëm, të familjeve të tyre.


Informacioni për Qeverisjen Vendore

Për të marrë të dhëna sa më të sakta e të drejtë për drejta se sa informacion kanë të rinjtë e kampionuar në Bashkinë e Mallakasterit për Qeverisjen Vendore, sesionin e pyetësorit për këtë qëllim ne e hapëm me dy pyetje kuic. Pyetja kuic “Në Bashkinë ku ju banoni organi vendimarrës është ?” katër alternativa, ku vetëm njëra është e saktë. Pyetja ka qëllim latent, sepse e merr informacionin në mënyrë të fshehtë. Katër alternativat ishin: a) *Këshilli Bashkiak*, që është edhe alternative e saktë, b) *Kryetari i Bashkisë*, c) *Administrata*, të cilat ishin dy alternativat e gabuara, dhe d) *Nuk e di*, një alternativë që i lejon të pyeturit të shpreh padijen e tij në këtë pyetje. Për çështje të etikës së studimit, por edhe për të qënë sa më të sinqertë me kampionin tonë ne e kemi përfshirë alternativën “Nuk e di” në të gjitha pyetjet e tjera të pyetësorit të cilat kërkojnë të vjelin të dhëna mbi informacionin që ata kanë apo të masi opinionet e të pyeturve. Kësaj pyetje të rinjtë ju përgjigjen si në tabelën e mëposhtme.



Grafik 6- Organi Vendimmarrës

Vetëm 34% janë përgjigjur sakt pyetjes së parë kuic. 18% janë shprehur që nuk e dinë përgjigjen, dhe 48% janë përgjigjur gabim. Që na kjo pyetje elementare ne kuptojmë që të rinjtë e Mallakasterit kanë një mungesë të theksuar të njohjes së organizmave, e mekanizmave të pushtetit vendor. Nëse e shikojmë në përgjithësi vetëm 34% e të rinjëve kanë informacion të vlefshëm se kush i merr vendimet në bashkinë e tyre, ndërsa 66% e tyre nuk e kanë këtë informacion. Pra pjesa më e madhe e të rinjëve nuk janë koherent që vendimarrja për çështje që ata i shqetësojnë ose i prekin merren nga Këshilli Bashkiak. Nëse i analizojmë përgjigjet e kësaj pyetje duke marrë për bazë edhe variablin “Arsim”, të dhënat janë:




Grafik 7- Informacioni mbi O.Vendimmarrës-Arsimi

Siç edhe pritej të arsimuarit e nivelit të lartë kishin informacion të saktë me një peshë specifike 62.1%, shumë më shumë se ata me arsim 9-vjeçar 10% edhe ata me arsim të mesëm 25.48%. Edhe tek ata me arsim të lartë mungesa e këtij informacioni elementar është e konsiderushme 37.95%. Por tek dy kategorit e tjera, mungesa e informacionit është dominante. Tek të rinjtë me 9-vjeçare 10% janë përgjigjur saktë edhe 90% kanë munges informacioni. Ndërsa tek ata më të mesme vetëm 25.48% janë përgjigjur sakt, ndërsa 74.52% jo.

Pyetja pasuese është përsëri një pyetje latent, kuic. Edhe qëllimi i kësaj pyetje është të mbledhi të dhëna se sa informacion kanë të rinjtë në lidhje me pushtetin vendor. Kundrejt pyetjes së mësipërme, pyetja nr.8 nuk është teorike: “Sa herë mblidhet Këshilli Bashkiak në Bashkinë tuaj?”. Me rregullore Këshilli Bashkiak mblidhet një herë në muaj. Në raste të jashtëzakonshme Këshilli mundet të mblidhet më shumë se një herë, por në funksionalitetin normal të tij ai mblidhet vetëm një herë në muaj. Nga kjo pyetje ne masim nivelin e informacionit tek të rinjtë,


por në të njëjtën kohë masim edhe lidhjet e tyre me pushtetin lokal. Masim se sa e ndjekin të rinjtë politikën lokale, sa afër saj janë edhe sa është interesi i tyre për të. Pyetja i vë përpara gjashtë alternativash, ku katër janë të gabuara, një është e sakta edhe alternativës “Nuk e di”. Përgjigjet e marra na japin një pamje si më poshtë.



Grafik 8- Mbledhjet e Këshillit Bashkiak


Vetëm 25% e të rinjëve në kampionim kanë dhënë një përgjigjë të sakt, që rrjedhimisht vetëm 25% kanë një informacion të saktë për mbledhjet e Këshillit Bashkiak. 14% janë përgjigjur gabim, ndërsa 61% me vetëdije pranojnë që nuk e dinë sa herë mblidhet Këshilli Bashkiak. Në këtë pyetje niveli i informacionit është edhe më i vogël se sa në pyetjen e mëparshme, që ishte më shumë një pyetje teorike se sa praktike. Kjo tregon një distancë të madhe bashkëpunimi, interesi edhe vëmëndjeje mes të rinjëve edhe pushtetit lokal. Pikërisht në këtë pyetje të studimit del në pah kjo lidhe, të rinjtë - qeveria lokale, e cila është në fokus edhe të dy pyetjeve pasardhëse, por që reflektohet edhe në këtë tabelë si shumë e dobët. Këto përgjigje të kësaj pyetje marrin më shumë kuptim dhe na japin një pamje më të qartë të realitetit. Në kategorinë e personave me arsim 9-vjeçar, 100% japin përgjigjëse se nuk e dinë sa herë mblidhet Këshilli Bashkiak. Kjo tregon sinqeritet të personave të pyetur, por edhe një mungesë të theksuar informacioni edhe indiferentizëm të kësaj kategorie të rinjsh ndaj pushtetit lokal. Të rinjtë me arsim të mesëm që i janë përgjigjur saktë pyetjes janë 21.56%. 13,72% e tyre i janë përgjigjur gabim edhe 64.68% me vetëdije pranojnë që nuk kanë informacion se sa here mblidhet këshilli

bashkiak. Tek të rinjtë me arsim të lartë pesha specifike e përgjigjes së saktë është 48.3%, shumë më e lartë nga dy kategoritë e tjera. Kjo si rrjedhojë e njohurive të konsoliduara që këta të rinjë supozohet që të kenë. Gjithsesi tabloja në përgjithësi tregon një mungesë informacioni nga të rinjtë.




Grafik 9- Mbledhjet e K. Bashkiak- Arsimi

Në pyetjen vijuese, e cila është një pyetje e drejt për drejtë, rezultatet janë treguesi më i fortë për interesin e të rinjëve ndaj politikës vendore, edhe treguesi më i fortë i lidhjes tepër të dobët ndërmjet pushtetit lokal edhe të rinjëve. Kampionit i është drejtuar pyetja “A keni marrë pjesë ndonjëherë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak?”. Edhe të dhënat e mbledhura japin rezultatin 100% (JO). Ky është treguesi më i fortë i cili tregon se të rinjtë në Bashkinë e Mallakasterit jo vetëm që janë të distancuar prej pushtetit vendor, por krejt të çinteresuar për vendimet që ky pushtet ndërmerr për ta, dhe për shërbimet që ai ofron për ta. Fakti që asnjë i ri nuk është interesuar të marr pjesë në një mbledhje të Këshillit tregon që të rinjtë nuk kanë asnjë lloj informacioni se çfarë çështjesh apo temash diskutohen në këto mbledhje. Për rrjedhim të rinjtë e kesaj bashkie nuk dinë as se çfarë vendimesh merren në emër të tyre, megjithë se shumë pak dinin edhe kush merrte vendime për ta.




Grafik 10- Pjesëmarrja në mbledhjet e Këshillit Bashkiak

Në bazë të të dhënave që na jep pyetja nr.10 kuptojmë që të rinjtë në një pjesë të konsiderueshme të tyre, i njohin Këshilltarët që përfaqësojnë lagjen apo zonën e tyre në Këshillin Bashkiak. Kjo për arsyen sepse ata mundet të jenë njëri ndër të njohur, me reputacion në zonën e tyre dhe deri diku të famshëm. Por nga rezultatet e mësipërme del që të rinjtë nuk kanë informacion të mjaftueshëm se çfarë bëjnë pikërisht këta këshilltar Bashkiak. 47% e të rinjëve kanë deklaruar se e njohin përfaqësuesin e zonës së tyre në Këshill. Megjithëse pjesa më e madhe prej 53%, deklarojnë se nuk e njohin, përsëri ky tregues është i konsiderueshëm duke pasur parasysh nivelin e ulët të informacionit edhe të interesin që të rinjtë kanë treguar. Në zonat rurale të rinjtë janë përgjigjur 50% me 50%, nëse i njohin apo jo përfaqësuesit e zonës së tyre në këshill, ndërsa në qytet pesha specifike e atyre që janë përgjigjur me (PO), është më e vogël, 41.67% , ndërsa ata që janë përgjigjur me (JO) është 58.33%. Kjo vjen si arsye ngaqë në zonat rurale komunitetet janë më të vogëla edhe më të afërme me njera tjetren. Është e lehtë për këshilltarët të identifikohen në këto komunitete.



Grafik 11- Informacioni mbi Këshilltarët

Një pyetje u është drejtuar të rinjëve me në fokus Kryetarin e Bashkisë. Më së shumti kjo pyetje ka të bëjë më pozicionin zyrtar e politik të kryetarit sesa atë individual. Të rinjëve u është kërkuar të identifikojnë funksionet e Kryetarit të Bashkisë nga shtatë alternat që u janë ofruar. Tre prej tyre janë të sakta, dy jo, një alternative është e hapur në të cilën të rinjtë të gjejnë mundësin të shprehen nëse dinë diçka më shumë, dhe alternative “Nuk e di”. Pas pyetjeve për Këshillin Bashkiak në këtë pyetje ne jemi përpjekur të masim nivelin e informacionit për organin tjetër të qeverisjes vendore, Kryetarin e Bashkisë. Përgjigjet e të rinjëve ishin :




Grafik 12- Funksionet e Kryetarit të Bashkisë

Më së shumti të rinjtë e njohin Kryetarin e Bashkisë për emerimet edhe shkarkimet e drejtuesëve të institucioneve në vartësin e Bashkisë, 55% e tyre e kanë zgjedhur si një të rinjtë prej alternativave. Në përgjigjet e mësipërme disa prej të rinjëve janë përgjigjur me një alternativë, disa me dy e disa me tre. Prandaj ne po e shqyrtojmë secilën alternativë në peshën specifike të

saj. Vetëm 22% kanë zgjedhur alternativën “Zbaton Aktet e Këshillit Bashkiak” , që ka të bëjë me funksionin ekzekutiv të Kryetarit të Bashkisë, funksioni parsor që ai ka. Raportimin përpara Këshillit Bashkiak e kanë zgjedhur vetëm 14% e të rinjëve. Kjo vërteton që shumica e të rinjëve nuk e njohin funksionimin e pushtetit vendor, dhe nuk i njohin vartësitë dhe funksionet e institucioneve. Edhe për Kryetarin e Bashkisë, informacioni është i pakët tek të rinjtë, dhe me shumë mundësi ai merret në forëm jo formale, nga bisedat e ndryshme me njëri-tjetrin, ose duke dëgjuar të tjerët. Kjo është edhe një arsye pse në shumicën e herëve ai mungon ose është i gabuar.

Problematikat Rinore dhe informacioni mbi aktivitetet social-kulturore

Në këtë sesion pyetjet kanë qëllim të identifikojnë më së shumti problematikat që i prekin e shqetësojnë të rinjtë në Bashkinë e Mallakasterit. Gjithashtu qëllim në këtë session është që të marrim sa më shumë informacion për nismat dhe aktivitetet që qeverisja lokale ndërmerr me në fokus të rinjte për problematikat rinore, dhe çështjet që prekin e shqetësojnë të rinjtë. Mënyra e matjes së këtyre variablave, është nëpërmjet vëtit të rinjve të cilët janë target grupi i atyre aktiviteteve e nismave që duam të masim. Pyetja e parë në këtë sesion kërkon të masë opinionin e të rinjve mbi ndikimin e qeverisjes lokale në problematikat rinore. Pyetja 12 na jep një opinion të të rinjve të mbledhur si më poshtë.




Grafik 13- Ndikimi I Qeverisjes lokale ne politikat Rinore

22% e të anketuarve nuk e shikojnë qeverisjen lokale si një ndikues në zgjidhjen e problematikave të tyre. 12% deklarojnë se qeverisja lokale ka pak ndikim në zgjidhjen e problematikave rinore. Janë përgjigjur me alternativën (Disi) 24% e të pyeturve. Në total pesha specifike e mosbesuesve është 34%, më e vogël se e atyre që besojnë që qeverisja lokale ka ndikim në zgjidhjen e problematikave të tyre, me një pëshë specifike prej 42%. 24% janë përgjigjur alternativës (Shumë), dhe 18% mendojnë se qeveria lokale ka plotësisht ndikim në zgjidhjen e problematikave të tyre. Ajo çfarë kuptojmë nga këto të dhëna është që të rinjtë kanë pritshmëri nga qeverisja lokale, dhe kërkojnë që ajo të bëhet faktorë në zgjidhjen e problemeve të tyre. Një e dhënë kjo që bie në kontrast me interesin e ulët që të rinjtë e Mallakasterit tregojnë ndaj politikës lokale.

Në pyetjen nr.13 jemi përpjekur të masim çështjet që i shqetësojnë më shumë të rinjtë në zonën ku ata jetojnë. Kjo pyetje na sjell një pamje më të qartë të problemeve që shqetësojnë të rinjtë në këtë komunitet.


Siç pritej problemet ekonomike renditen të parat me 59%. Ato ndiqen nga papunësia me 56%. Që në fillim të studimit në vërejtëm që kampioni jonë është i përfaqësuar më së shumti nga shtresa të e ulët dhe e mesme e ulët. Kampioni është një pasqyrim i realitetit, dhe realisht

tek të rinjtë e Mallakasterit gjendja e keqe ekonomike edhe papunësia janë problemet kryesore dhe më të rëndësishme. Ato ndiqen nga shërbimi shëndetësor që të rinjtë e kanë cilësuar si problemin e tretë më të rëndësishëm. Abuzimi me drogat dhe alkoolin është një tjetër problem i cili zë vendin e katërt më të rëndësishëm, ndjekur nga mungesa e ambienteve sportive me 20%. Të rinjtë e Mallakasterit kanë zgjedhur dhe problem të tjera si mungesa e edukimit qytetar, krimi, angazhimi i ulët në promovimin e të drejtave të njeriut. Bie në sy pesha specifike tepër e ulët që zë (Angazhimi i ulët në jetën publike dhe qeverisje) i cili zë vetëm 7%. Të rinjtë e Mallakasterit preken nga problematika shumë të drejtëpërdrejta dhe konkrete sesa angazhimi në jetën publike dhe qeverisje. Kjo është ndoshta një arsye e justifikueshme për interesim të përgjithshëm të ulët të treguar ndaj qeverisjes lokale.



Grafik 14- Problematikat Rinore

Në pyetjen nr.14 të rinjtë janë pyetur se çfarë rëndësie kanë çështjet rinore për pushtetin vendor në bashkinë e tyre. Ata japin opinionet e tyre, por që në mënyrë të tërthortë janë një vlersim i tregues i punës i prezencës së punës së Bashkisë tek të rinjtë.




Grafik 15- Pushteti Vendor- problemet Rinore

Bie me një herë në sy pesha specifike prej 28% e përgjigjes (duhet të konsiderohet). Që tregon së një pjesë e madhe kanë rezerva ndaj pushtetit vendor. Por e lartë qëndron edhe pesha specifike e të rinjëve që janë përgjigjur me alternativën (Nuk e di). Kjo verteton sërisht atë problematikë që kemi identifikuar që në fillim, mungesën e informacionit nga ana e të rinjëve për pushtetin lokal, por edhe një lidhje të dobët bashkëpunimi mes të rinjëve edhe pushtetit lokal. 17% e të rinjëve nuk i quajnë kopetencë e Bashkisë çështjet rinore. Ky është një tregues tjetër i mungesës së informacionit, por dhe i humbjes së besimit nga ana e të rinjëve. Një pjesë e të rinjëve prej 14% janë përgjigjur se çështjet rinore janë shumë të rëndësishme për pushtetin vendor, dhe 3% janë përgjigjur se janë prioritete. 11% janë përgjigjur se janë disi të rëndësishme. Këto përgjigje positive janë një tregues se një pjesë e të rinjëve kanë pritshmëri nga pushteti lokal për çështjet rinore.


Pyetja nr.15 kërkonë të krijoj një perceptim të përgjithshëm se sa aktive është rinia në Bashkinë e Mallakasterit. Ky perceptim krijohet nga opinion dhe vlersimi i vetë të rinjëve. Ky perceptim na jep ne një pamje më të qartë për aktivizmin dhe angazhimin e rinise në këtë Bashki, por edhe të njohim perceptimin që ata kanë për vete. Edhe në këtë perceptim 62% deklarojnë se rina nuk është aspak aktive, dhe 27% pak aktive. Pamja që na jepet nga vetë të rinjtë, tregon një

rini pasive dhe të pa angazhuar. 8% janë përgjigjur me alternativën (Disi), vetëm 2% kanë deklaruar se është shumë aktive, edhe 1% plotësisht aktive.




Grafik 16- Aktivizmi I te rinjve

Në pyetjen nr.19 e cila nuk është ndjekse e pyetjes së mësipërme por që janë të lidhura me njëra-tjetrën të rinjtë pyeten se kush organizon aktivitete për të rinjtë në komunitetin e tyre. Bie në sy një punë e mirë e Drejtorisë Arsimore të Mallakasterit, ku 37% e të rinjëve deklarojnë se aktivitetet rinore në komunitetin e tyre i organizon pikërisht nga Drejtoria Arsimore. Ky është një tregues që shkolla mbetet i vetmi vend ku të rinjtë mundet të grupohen, dhe të organizojnë aktivitete. Vetëm 13% deklarojnë se aktivitetet rinore i organizon Bashkia. Një peshë specifike kjo për tu konsideruar. Por është tepër e lartë pesha specifike e atyre të rinjëve që nuk janë në kontakt me aktivitetet rinore. 25% e të rinjëve deklarojnë se në komunitetin e tyre nuk ka fare organizime për të rinjtë, edhe 20% zgjedhin alternativën (Nuk e di). Në total këta të rinjtë të distancuar nga aktivitetet rinore zënë një peshë specifike prej 45%. Pjesa më e madhe e tyre janë ata që banojnë në zonat rurale, në të cilat edhe organizimet e institucioneve të qeverisë lokale janë teoër të ralla. Është shumë e vogël pesha specifike e të rinjëve që zgjedhin Ministrin e Mirqënies Sociale dhe Rinisë si alternative, vetëm 3%, por është akoma më e vogël pesha specifike e të rinjëve që zgjedhin OJF-të , vetëm 2%. Është shqetësues fakti që në këtë Bashki nuk veprojnë OJF-të me në fokus rininë, në një zonë që ka shumë nevojë për këtë shërbim.



Grafik 17- Stakeholders- grupet e interesit

Për të matur se sa aktive është Qeverisja Lokale në aktivitetet që ajo kryen, sa e pranishme është në komunitet dhe sa e prekshme nga të rinjtë, ne i kemi pyetur ata se a kanë marr pjesë në ndonjë nga aktivitetet që ka organizuar Qeverisja Lokale?! 51% e të rinjëve kanë deklaruar që kanë marrë pjesë në një aktivitet që organizon Qeverisja Lokale, 47% kanë deklaruar JO, dhe 2% nuk janë përgjigjur. Kjo është një shifër e kënaqëshme, sidomos kur 53.12% e të rinjëve nga zonat rurale deklarojnë se kanë marr pjesë në një aktivitet të organizuar nga Bashkia, shumë më e lartë nga të rinjtë e qytetit që deklarojn (PO vetëm 47.22%. Ka një shfaqje të pushtetit vendor tek të rinjtë, le të themi një kontakt mes tyre, i cili duket sikur është më i lartë në fshat se san ë qytet. Por përsëri e lartë është pesha specifike e atyre që nuk kanë marrë as një herë pjes në një aktivitet të organizuar nga Bashkia, 47% në total, 45.31% në zonat rurale edhe 50% në qytet. Ky rezultat tregon një angazhim të ngadaltë dhe të vakët të Qeveris Lokale ndaj komunitetit.



Grafik 18- Pjesemarrja ne aktivite lokale

Të dhënat e pyetjes së më sipërme kanë të bëjnë me aktivitetet e Bashkisë. Por jo me aktivitetet rinore të Bashkisë. Për këtë lidhje variablash “aktivitete rinore nga Bashkia”, ne, me anë të një pyetjeje pasardhëse (nr.17), mblodhëm të dhëna. A organizonë Qeverisja Lokale aktivite me në fokus rininë?!- kjo ishte edhe pyetja që ju drejtua të rinjëve. Në këtë pyetje ne e këthejmë vëmëndjen tek rinia dhe nismat që Pushteti Lokal ndërmer specifikiisht për të rinjtë. Në këtë pyetje matet drejt për drejtë angazhimi i Bashkisë për të rinjtë edhe se sa dukëshëm edhe prekëshëm është ky angazhim nga vetë të rinjtë.

Të rinjtë janë përgjigjur në masën 80% që Bashkia nuk organizon në zonën ku ata banojnë, aktivite që të kenë në fokus të rinjtë edhe problematikat që ata i shqetësojnë. Kjo është dëshmia më e fortë në këtë studim për haresën e të rinjëve nga ana e Bashkisë. 16% e të rinjëve nuk janë përgjigjur, që ridëshmon mungesën e raporteve mes Pushtetit Lokal edhe rinisë së Mallakasterit. Gjithashtu tregon edhe neglizhence nga të rinjtë. Por 4% e të rinjëve i janë përgjigjur pozitivisht pyetjes, një peshë specifike shumë e ulët. Përgjigjet pozitive shfaqen vetëm në qytet. Ato zënë një peshë specifike 11.1% të përgjigjeve nga të rinjtë e qytetit që është shumë pak, edhe 0% nga zonat rurale. Në një konkluzion të thjeshtë Bashkia nuk ka organizuar as një herë aktivite për të rinjtë, ose me fokus te problematikat rinore në zonat rurale. Ajo ka

orgazizuar të tilla vetëm në qytet, edhe ato shumë pak të aksesueshme nga të rinjtë e qytetit, 77.8% e të cilëve janë përgjigjur negativisht pyetjes sonë.




Grafik 19- Organizimi I aktiviteteve per te rinjte

Nga të dhënat e pyetjes vijuese nr.18, 90% e të rinjëve të kampionuar nuk kanë djeni për ekzistencën e një Strategjie Rinore. Strategjia Rinore është produkt i Ministrisë së Mirqënies Sociale edhe Rinis i cili u miratua në vitin 2015. Ndërsa në pushtetin vendor në çdo fillim vitit Bashkia miraton buxhetin bashkiak, ku përfshihet edhe zëri për rininë, i cili shpeshherë është i bashkangjitur me kulturën e sportin. Buxheti miratohet në bazë të projekt propozimeve që mundet të jenë aktivitete, nisma të ndryshme, shërbime, ambiente për të rinjtë etj. 90% e të rinjëve nuk kanë informacion për as njëri nga këto, dhe 5% nuk janë përgjigjur. Vetë 5% janë përgjigjur se kanë informacion për ekzistencën e një strategjie rinore, apo të planifikimeve rinore nga Bashkia. Situata është pothuaj se e njëjtë si tek të rinjtë në fshat ashtu edhe tek të rinjtë në qytet.



Grafik 20- Informacion mbi Strategjine e Rinise

Në pyetjen që vijonë më pas testohet marrëdhënia e drejtëpërdrejtë ndërmjet qeverisjes lokale dhe të rinjve. Këta të fundit pyeten se a janë drejtuar ndonjëherë Qeverisë Lokale për ndonjë problematik rinore, shqetësim lidhur me të rinjtë apo për aktivitete në lidhje me rininë. Këtu kërkohet të matet sesa e aksesueshme është Bashkia nga të rinjtë dhe sa të rinjtë e shikojnë Bashkinë si një alternativë për zgjidhjen e problemeve të tyre.




Grafik 21- Aktivizmi I te rinjve- Qeverisje

81% janë përgjigjur se nuk janë drejtuar asgjëherë tek organet e Qeverisjes Lokale për ndonjë aktivitet në lidhje me rininë dhe as për ndonjë problematikë rinore. 18% kanë deklaruar që PO, janë drejtuar organeve të pushtetit Vendor, 1% nuk janë përgjigjur. Shifrat tregojnë një distancë shumë të madhe në mes të rinjve dhe pushtetit Vendor. Kjo distancë në këtë marrëdhënie dy palëshë është më e largët në qytet sesa në fshatë. Në qytet pesha specifike e të rinjvë që nuk i janë drejtuar asnjëherë Bashkisë është 94.4% , kundrejtë fshatit që këtë shifër e ka 73.4% . Kjo tregon që të rinjtë, më shumë në qytqt sesa në fshatë, nuk i drejtohen pushtetit lokal për problematika që i shqëtesojnë apo për aktivitete në lidhje me target-grupin e tyre.


Ne i drejtua të rinjvë pyetjen “ A ka nevojë Qeverisja Lokale për këshillim edhe nxitje nga komuniteti për më shumë vëmëndje tek rinija ?”. Kjo pyetje ngrihet në përputhje me kuadrin e projektit që ky studim i vjen në ndihmë. Në këtë pyetje matet opinion it ë rinjvë nëse komuniteti, pra vetë ata duhet të kenë një rol më aktiv në vendimarrje, duke u përfshirë si këshillues edhe si nxitës ndaj Pushtetit Lokal për më shumë vëmëndje ndaj të rinjvë. 82% e të rinjvë janë përgjigjur me PO pyetjes. Deri diku kjo tregon edhe një gadishmëri të tyre për tu përfshirë në këtë nisëm. Vetëm 14% janë përgjigjur negativisht, edhe 4% nuk janë përgjigjur. Duhet të kemi parasysh rezultatet e mara deri tani që tregonin një rini pak të interesuar edhe një lidhje të dobët mes Pushtetit Lokal edhe të rinjvë.

A ka nevoje Qeverisja Lokale per keshillim edhe nxitje nga komuniteti per me shume vemendje tek rinia ?




Grafik 22- Qeverisja locale- komuniteti

Kush duhet ta luaj këtë rol këshillues tek Pushteti Lokal – lind rrjedhimisht pyetja. 71% e të rinjëve mendojnë se këtë rol këshillues duhet ta luajë Qeveria. Shumë prej tyre besojnë edhe presin një rolë më aktivë nga organet e Pushtetit Qëndror. 38% mendojnë se këtë rol duhet ta luajnë edhe OJF-të e ndryshme. Nga të dhënat e mësipërme të këtij studimi rezultoj që puna e OJF-ve me të rinjtë në këtë Bashki ishte për të dëshiruar, edhe një rezultat i till pritej kur besimi te OJF-të është i vogël. Por për tu përgëzuar është fakti që 52% e të rinjëve zgjedhin Komunitetin për të luajtur këtë rol nxitës edhe 64 % zgjedhin veten e tyre për të luajtur këtë rolë nxitës edhe këshillues. Kjo tregon që në një farë mase, të rinjtë në këtë Bashki kanë një sens përgjegjësie për aktivizëm qytetar, por dukshëm i mungojnë faktorët edhe mënyrat e organizimit.




Grafik 23- Roli I institucioneve ne aktivizmin e te rinjve

Projekti të cilit ky studim i vjen në ndihmë ka në fokus Grupet Këshillimore Rinore. 72% e të rinjëve të kampionuar nuk kishin dëgjuar asnjë herë për këto grupe këshillimore. 27% deklaruan se kishin dëgjuar, vetëm 1% nuk u përgjigjën. Të rinjtë e qytetit ishin më të informuar për këtë grupim, në masën 36.1%, kundrejt të rinjëve që banojnë në zonat rurale 21.8%.



Grafik 24- Informacion mbi Grupet Keshillimore te te Rinjve

Sa të nevojshëm e gjykojnë të rinjtë e Mallakasterit një grupim rinor të organizuar që lobon tek organet vendimarrse të Qeverisjes Lokale për problematikat rinore?! Këtë pyetje ne ua drejtuam pikërisht atyre:



Grafik 25- Rendesia e Grupeve Keshillimore aktive

Ne ofruam si përgjigje një skemë të shkallëzuar e cila jepte më shumë hapsira për përgjigje, edhe tabela e tregon qartë interesin e lartë për këtë Grupim.

Rekomandime

Papunësia edhe gjëndja e ulët ekonomike janë dy nga faktorët që bien ne sy menjëhere gjatë studimit. Rinia e Bashkisë së Mallakasterit ka nevojë për më shumë orientim në tregun e punës, edhe për një strategji lokale të punësimit rinor në këtë Bashki.

Bashkia e Mallakasterit ka nevojë për OJF të cilat të kenë në fokus të rinjtë, aktivitetet dhe problematikat rinore, në vecanti. Organizimi edhe ndërgjegjësimi i të rinjve është një çështje e cila duhet parë me përparsi në këtë Bashki nga Shoqëria Civile.

Studimi nxjerr në pah një mungesë ndërveprimi mes Qeverisjes Lokale edhe të Rinjve. Nga ana e Qeverisjes Lokale ky problem duhet parë me prioritet, sepse apatia tek të rinjtë për politikëbërjen po rritet.

Qeverisja Lokale në këtë Bashki lë shumë për të dëshiruar në organizimet për rininë. Ajo duhet t'i kushtojë një vëmendje të vecantë këtij target-grupi. Pra duhet të organizohen specifikiisht aktivitete me në fokus rininë edhe problematikat e saj nga ana e Bashkisë.

Jeta rinore në Bashkinë e Mallakasterit është apatike dhe mungon aktivizmi rinor. Duhet te punoht me shume në ndërgjëgjësim edhe aktivizim te rinisë e kauzave rinore, nga faktore e element të ndryshëm social, qofshin politik ose jopolitik.

Të rinjtë në Bashkinë e Mallakasterit kanë shumë pak informacion mbi Qeverisjen Lokale, strukturën edhe funksionimin e saj. Rinia e Mallakasterit ka nevojë për informacion dhe ndërgjegjësim për rolin e Qeverisjes Lokale edhe ndikimin e saj në jetën e rinisë e komunitetit në tërësi.

Duhet rritur roli i të rinjve në vendimarrje locale dhe qendrore. Vetëm në këtë mënyrë të rinjtë edhe komuniteti do të ushtrojnë trysni tek organet e pushtetit mbi problematikat e tyre. Kjo mund të vijë vetëm si pasojë e një ndikimi nga një faktor i jashtëm, i cili të organizojë, informojë dhe trajnojë të rinjtë se si ta rrisin rolin e tyre në vendimarrje e të faktorizohen.